



Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Prishtinë, 25.11.2015. në orën 13:30

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-2

PROCESVERBAL

i mbledhjes së Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Zhivković, Agim Çeku, Mufera Shinik, Agim Kikaj, Milka Vuletiq, Sasha Milosavleviq, Slavko Simiq, Qerim Bajrami, Danush Ademi dhe Veton Berisha

Munguan: Fisnik Ismaili dhe Rustem Berisha.

Pjesëmarrës të tjerë në mbledhje : Ardiana Gashi- përfaqësues nga OSBE-ja, Zijush Ahmeti - konsulltant i Sekretariatit të KKK dhe Celal Iliaz, nga Drejtoria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Stafi mbështetës i Komisionit: Natasha Prica-Tishma, koordinatore dhe Drita Çarkaxhiu, zyrtare e lartë ligjore.

Mbledhjen e kryesoi: **Jasmina Zhivković**, kryetare e komisionit

Për këtë mbledhje u propozua dhe u miratua ky:

REND DITE:

- 1. Raportimi i ministrit të Ministrisë për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, z. Arsim Bajrami dhe i rektorit të Univesitetit të Prishtinës z. Ramadan Zejnullahu, për procedurat e pranimit të kandidatëve të komuniteteve joshumicë për regjistrim në nivelin universitar për vitin akademik 2015/16.**

Kryetarja Jasmina Zhivković, e hapi mbledhjen e komisionit dhe përshëndetiministrin e arsimit z. Arsim Bajrami dhe rektorin e universitetit z. Ramadan Zejnullahu.

Ajo theksoi se, Komisioni në kuadër të kompetencave të saja ka paraqitur kërkesë me rekomandim për ministrin dhe rektorin që të shpalljet konkursi i tretë plotësues, për regjistrimin e studentëve të komuniteteve joshumicë, në pajtim me Ligjin për shkollimin e lartë, në mënyrë që të sigurohet çasja e barabartë në shkollimin e lartë në nivelin universitar.

Konsidreoj se një situatë e tillë paraqet shkelje të rregullave të procedurës për komunitete joshumicë si qytetarë të Reublikës së Kosovës, në raport me kategoritë nga regjioni, për të cilat konkursi ka qenë i shpallur. Janë pranuar vetëm 10% nga 328 vende të rezervuara për komunitetin joshumicë, ndërsa shumica kanë mbetur jashtë dyerve të fakultetit. Me qëllim të sigurimit që të drejtat dhe interesat e komuniteteve të jenë të trajtuara në mënyrë adekuate, në lëmin e arsimit dhe në pajtim me rekomandimin e komisionit të datës 21.09.2015. Sot nga ju presim përgjigje zyrtare lidhur me këtë situatë.

Pas fjalës hyrëse, kryetarja i ftoi anëtarët e komisionit që të marrin pjesë në debat në formën e shtrirjes së pyetjeve apo sugjerimeve.

Qerim Bajrami—shfytëzoi rastin që sot të shperh pakënaqësitë dhe shqetësimet e mia, lidhur me mospublikimin e konkursit për regjistrim në afatin e tretë, të studnetëve nga radhët e komunitetit joshumicë, në vendet e rezervuara në fakultete të Universitetit të Prishtinës, të cilët kanë aplikuar në afatin e parë të regjistrimit. Nga 328 vende të rezervuara, janë regjistruar 20-30 kandidatë, pra vetëm 10% në të gjitha fakultetet e universitetit.

Për shkak të mossigurimit të qasjes jo të barabartë në shkollimin e lartë në nivelin universitar, konsideroj se ka shkelje të të drejtave të komuniteteit joshumicë, për shkak të mospublikimit të konkursit për regjistrim në afatin e tretë nga ana e rektoratit, edhe pse ai konkurs ka qenë i shpallur për pjesëtarët e komunitetit shumicë dhe të gjitha kategoritë e privileguara nga regjioni.

Theksoi se ende nuk janë shtypur testet për pranim në fakultete në gjuhët e kandidatëve të komunitetit joshumicë, apo sëpaku në gjuhët tjera zyrtare, sepse iu pamundësohet plotësimi i testit, gjatë afatit të shkurtër, për dhënien e provimit pranues. Për këto probleme, përkundër shume apeleve, gjatë mbledhjeve formale dhe joformale, nuk ka reagim pozitiv as dëshirë nga MASHT-i dhe rektorati i UP-së që të zgjidhet ky problem, pra të regjistrohen studentë nga radhët e komuniteteit joshumicë. Pa marrë parasysh se ata janë qytetarë të Kosovës dhe se shtetit ia paguajnë tatimin, ata nuk e kanë shfrytëzuar të drejtën e tyre. Për shkak të këtyre mangësive sa më shpejt që është e mundur ne do të punojmë për përmirësimin e ligjit ekzistues për arsimin e lartë, në mënyrë për të zgjidhur këtë çështje në mënyrë që të sigurohen këto të drjta se nuk është e drejtë të varet nga vullneti i ministrisë

Për këto arsye, unë, si pjesëtar i komunitetit tim, mund të them se kjo është lëshim institucional dhe një formë e diskriminimit të të drejtave të cilat na takojnë sipas ligjeve të Republikës së Kosovës.

Veton Berisha—si përfaqësues i komunitetit Egjiptas theksoi si element mjaft të rëndësishëm të këtij problemi koordinimi institucional në të ardhmen në mes Komisionit, Ministrisë dhe Rektoratit si organe të pushtetit ekzekutiv. Arsimimi është fusha më e rëndësishme për zhvillimin e shoqërisë.

Është referuar se një kohë të gjatë jemi orvatur që ne si përfaqësues të komuniteteve të vëmë kontakte me ju dhe zyrën e MASHT-it, qoftë në formën e kërkesave, qoftë në formën e ftesave për zgjidhjen e problemit të regjistrimit të studentëve nga radhët e komuniteteve pakicë, dhe posaçërisht në procesin e afatit të dytë të regjistrimit në pajtim me kriteret e pëcaktuara, por nuk kemi hasur në mirëkuptim. Para fillimit të vitit akademik është dashur të hartohet një plan i përbashkët i veprimit i cili do të siguronte koordinimin e interesave të komuniteteve nga njëra anë, dhe koordinimi i politikave dhe ligjeve në fuqi nga ana tjetër. Mjerisht, kjo ka qenë e pamundur, andaj, tani në këtë fazë, kjo çështje nuk mund të zgjidhet. Konsideroj se veprimi i tillë i organeve shtetërore paraqet lëshim institucional dhe shkelje të preambulës të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe, legjilacionit, interesave vitale të komunitetit pakicë. Si dhe shkeljen e një sërë dokumenteve ndërkombëtare, të cilat ua sigurojnë minoritetet të drejtat e tyre, rëndësia e të cilave është e madhe, e ato janë: Deklarata për të Drejtat e Njeriut dhe Qytetarit, Konventa Kornizë për Mbrotjtjen e pakicave kombëtare, Konventa e Evropës për mbrotjtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Drejtave Themelore e tjerë.

Është e domosdoshme që institucionet e sistemit të sigurojnë veprim të barabartë, respektimin dhe trajtimin e komunitetit pakicë, të cilat janë pjesë dhe kanë hapsira në institucionet publike të Republikës së Kosovës.

Shumë shpejt Kuvendi do të ndryshojë Ligjin për shkollimin e lartë, icli do të pësojë ndryshime në pjesën e cila ka të bëjë me çështje të rëndësishme për komunitetet joshumicë, ndërsa ne dotë ndërmarrim hapat e rëndësishëm për menjanimin e dilemave dhe të paregullsive. Me qëllim të sigurimit që të drejtat dhe interesat e komuniteteve të jenë të trajtuara në mënyrë adekuate ne lëmin e arsimit si dhe çasja e tyre e barabartë në skollimin e lartë, dhe në pajtim me kërkesat tona, sot nga ju presim përgjigjen tuaj zyrtar dhe sugjerimet lidhur me situatën e krijuar.

Danush Ademi – Shrytëzoj rastin që sot të shprehim shqetësimet tona për gjendjen në Ministrinë e arsimit dhe në Rektoratin e Universitetit “Hasan Prishtina” për shkak të pamundësisë të regjistrimit të studentëve nga radhët e komuniteteve joshumicë në vendet e rezervuara në fakultetet e Universitetit të Prishtinës, të cilët kanë aplikuar në afati të parë të regjistrimit dhe mos shpallja e konkursit plotësues për regjistrimin e studentëve të komuniteteve joshumicë, edhe pse ai konkurs ka qenë i shpallur për pjesëtarët e komunitetit shumicë dhe të gjitha kategoritë e privileguara nga regjioni. Këtë veprim të Ministrisë dhe të Rektoratit e konsideroj diskriminim të drejtave tona të cilat na takojnë sipas ligjeve të Republikës së Kosovës.

Sipas të dhënave statistikore është regjistruar një numër i vogël i kandidatëve në krahasim me 328 vendet e rezervuara për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë. Ministri dhe rektori duhet të arsytojnë shkaqet përse pjesëtarët e komuniteteve joshumicë nuk kanë mundur të reaktizojnë të drejtën e tyre për regjistrim, pra të sqarojnë procedurën për pranimin e kandidatëve të komuniteteve joshumicë. Për shkak të kësaj gjendjeje edhe më tej kërkoj që të gjinden mundësitë për relizimin e kësaj të drejte, si dhe të drejtave të tjera, bursave studentore, me qëllim të mbrotjtjes së interesave të kandidatëve nga radhët e komuniteteve pakicë.

Muferra Sinic-thase do të ishte pozitive që MASHT-i në bashkëpunim me Rektoratin për hirë të tejkalimit të kësaj gjendjeje dhe me qëllim të mbrotjtjes së interesave të kandidatëve nga komunitete joshumicë, të shpallë konkurs dhe të zgjidhë këtë problem. Është e vërtetë se për

shkak të mungesës së testeve në gjuhët e kandidatëve, të njejtit nuk kanë arritur numër të njejtë të pikëve e jo për shkak të mosdijes. Këto komunitete nuk janë barrë për shtetin, por pasuri

Ministri, Arsim Bajrami

Pëgjegjet në pyetjet:

Ministri i MASHT-it z. Arsim Bajrami, ka theksuar se regjistrimi i studentëve nga komunitetet, që kanë aplikuar në Universitetin e Prishtinës, nuk treguan rezultate të kënaqshme në testin e hartuar në bazë të kriterëve për regjistrim, çështje që është shqetësuese edhe për ne.

Në konferencën me donatorët, është marrë qëndrim që të sigurohet buxheti për realizimin e testeve në gjuhët e komuniteteve dhe për mbajtjen e trajnimeve për këtë kategori të studentëve, me qëllim që të rritet efikasiteti dhe kalueshmëria e tyre. Në kuadër të këtij procesi i kemi siguruar 550 bursa për studentët e merituar dhe gjithashtu e kemi siguruar akomodimin në konvikte për studentët nga radhët e komuniteteve për vitin akademik 2015/2016

Si institucion i lartë arsimor dëshirojmë të evitojmë të gjitha dilemat dhe problemet. Në tërë këtë proces ekzistoh dukuria e keqpërdorimit të identitetit, ankesa të natyrave të ndryshme, përcaktimi i kretireve, procedurat e pranimit e tj. Ne jemi të gatshëm që t i zgjidhim në koordinim me ju, për çka edhe ligji na obligon.

Kam shpresë që kjo problematikë në vitin e ardhshëm të zgjidhet dhe do jemi të përkushtuar.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30

Njësia për komisione parlamentare Kryetarja e komisionit

Kryetare e Komisionit

Jasmina Zhivković